



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:044648
Datë: 27.02.2019
Numri i dokumentit: 00234750

P.nr.413/17

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prizren - Dega në Suharekë-Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Lavdim Bajraktari me pjesëmarrjen e sekretaren juridike Sherife Thaqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. A. Z. nga fsh. B. komuna Suharekë, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II.nr.451-4/17 të dt.29.05.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt. 21.02.2019, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Musli Gashi mbrojtësit sipas autorizimit av. N. B. nga Sukareka, dhe të akuzuarit S. Z., mori dhe publikishtë shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari S. Z., nga i ati A. dhe e ëma R.- e lindur J., i lindur me 08.01.1965 në fshatin B. Komuna e Suharekë me numër personal, me vendbanim rr. N. P. objekti 8 banesa nr... Prishtinë, i martuar, babai i katër fëmijëve, me profesion menagjer, i gjendjes së mesme ekonomike, me parë i pa dënuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 15.02.2017, rreth orës 16:50 min, në Suharekë në rrugën B. 1...pikërishtë përball argjendarisë “D.” duke shkelur ligjin mbi trafikun publikvepron në kundërshtim me nenin 42 dhe 49 të ligjit mbi komunikacionit rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, aq sa vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarve të markes “VW P. 1.9”, ngjyrë hiri metalike me targa të regjistrimit 01-...-GN kur arrin në vendin kritik shpejtësinë e lëvizjes së automjetit nuk ja përshtat kushteve dhe rretahave në rrugë duke qarkulluar në rrugën me dy shirita, në hiritin e djathtë të rrugës me të arritur përball argjendarisë “D.” kalon në shiritin e majtë të rrugës duke bllokuar rrugën e automjetit të markës “BMW ... D” ngjyrë të kaltër me targa 04-...-FB të cilën e voziste N. D. i cili në momentin kritik ishte duke lëvizur në shiritin etij qarkulles, nga ana e

kundërt , dhe për t'iu shmangur aksidentitkalon nga shiriti i majtë në të djathtë ku vie deri te goditja e pjesës së përparme të automjetit” VW V. “ ngjyrë hiri metalike me targa 04-...-AM të cilën e drejtonte B. K. i cili në momentin kritik ishte duke lëvizur në shiritin e tij qarkullues , nga drejtimi i kundërt me c'rast përvec dëmeve materile në të tri automjetet, lëndime të lehta trupore pësojnë : B. K. dhe M. K. lëndime këto më gjërësishtë të të konstatuara më mendimin e ekspertit mjeko ligjor të dr. M. G. të dhënë më dt 27.03.2017

-me këto veprime ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Gjykata në kuptim të neneve 7,17,23,41,43,46,73,74 si dhe nenit 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPK-së, nenit 248 dhe 365 të KPPRK-së të akuzuarit, ia shqipton:

DENIM ME GJOBË

Të akuzuarit S. Z. ia shqipton denimin me gjobë në shumë prej **170 € (një qind e shtatëdhjetë Euro)**, të cilin duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nese i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën gjykata mund të zavendësoj dënimin me gjobë në dënim me burg, ashtu që një ditë burgim llogaritet me 20 € (njetzet) Euro gjobë, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar ne dispozitën e nenit 46 paragrafi 3 te KPK-së.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 €, në emër të ekspertit të komunikacionit shumë prej 40.88 €, në emër të ekspertit mjeko ligjor shumë prej 50 €, dhe në emër të taksës për kompenzim të viktimave të krimit shumë prej 30 €, të gjitha këto pas plotëfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Të dëmtuarit B. Rr. K. dhe M. B. K. rr.”D.” nr. 1 Prizren dhe N. A. D. rr. “B. 1..” Suharek, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren- Departamenti i përgjithshëm me aktakuzen PP.II.nr.451-4/17 të dt.29.05.2017 ka akuzuar S. Z. nga fsh. B. Komuna Suharekë, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datën 21.02.2019 ku ka ftuar Prokurorin e Shtetit te Prokurorisë themelore në Prizren, dhe të akuzuarin S. Z. ashtu siq e parasheh neni 245 parag.1 te KPPRK-së.

Ne fillim te shqyrtimit fillestar, gjyqtari e ka udhëzuar te akuzuarin për të drejtat e tij, ashtu siq e parasheh neni 246 parag.1 i KPPRK-së, ku i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar udhëzimet.

Gjyqtari ka çmuar se e drejta e tij në mbrojtje është respektuar dhe se prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 të këtij kodi ashtu siq e parasheh neni 246 par. 2 i KPK-së.

Ne bazë të nenit 246 par. 3 te KPPRK-së prokurori i shtetit Musli Gashi ka lexuar aktakuzen PP.II.nr.451-4/17 të dt.29.03.2017 të Prokurorisë Themelore në Prizren , ku i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzen, dhe në bazë të nenit 246 parag.4 të KPPRK-së

pasi qe gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të akuzuarit i ka ofruar mundësinë të pranoj fajsinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajsinë në tërësi në të gjitha pikat e aktakuzës, pastaj gjyqtari ka përcaktuar se i akuzuari kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se pranimi bëhet vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajit mbeshetete ne faktet e qeshtjes qe përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnje shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, të gjitha këto të parapara me nenin 248 parag.1 te KPP-së.

Ne bazë te nenit 248 par.2 te KPP-së për vlerësimin e pranimit te fajsisë së të akuzuarit, gjyqtari ka kërkuar mendimin e prokurorit te shtetit dhe i njejtj deklaroj se janë plotësuar kushtet nga neni 248 parag.1 të KPP-së.

Ne bazë të nenit 248 parag.4 te KPP-se, pasi që gjyqtari u bind se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1 i ketij neni mori aktvendim me te cilin e pranoj pranimin e fajsisë nga i akuzuari dhe vazhdoj me shqyrtimin për vërtetimin e fakteve relevante per shqiptimin e denimit.

Prokurori i shtetit e Prokurorisë Themelore Prizren Musi Gashi lidhur me vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit ka deklaruar se mbetet pranë aktakuzes, se pranimi i fajsisë nga ana e të pandehurit është e mbeshetetur ne provat materiale, prova këto nga te cilat është ngritur aktakuza, andaj vlersoj se ky pranim i fajsisë eshte bërë ne menyre vullnetare dhe pa kurfare presioni dhe mbeshetetur mu në keto prova dhe në pajtim me vullnetin e të akuzuarit, i propozoj gjykatës qe me rastin e marjes se dënimit, pranimin e fajsisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

I akuzuari S. Z. ka deklaruar se pranoj fajsinë, gjykatës i premtoj se në të ardhmen nuk do të përserisë veprën te tilla dhe do të jem i kujdesshëm, pendohem per vepren e kryer penale, ketë veper e kam kryer për herë të parë, kërkoj nga gjykata që të më shqiptohet një dënim më i butë.

Duke i vlersuar me ndergjegjije provat e nxjerrura në procedur një nga një dhe në lidhje me provat tjera ne bazë te nenit 7 parag.1 dhe nenit 361 te KPP-se gjykata ka vertetuar ketë gjendje faktike.

Se me datë 15.02.2017, rreth orës 16:50 min, në Suharekë në rrugën B. 1...pikërishtë përball argjendarisë “D.” duke shkelur ligjin mbi trafikun publikvepron në kundërshtim me nenin 42 dhe 49 të ligjit mbi komunikacionit rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, aq sa vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarve të markes “VW P. 1.9”, ngjyrë hiri metalike me targa të regjistrimit 01-...-GN kur arrin në vendin kritik shpejtësinë e lëvizjes së automjetit nuk ja përshtat kushteve dhe rretahave në rrugë duke qarkulluar në rrugën me dy shirita, në hiritin e djathtë të rrugës me të arritur përball argjendarisë “D.” kalon në shiritin e majtë të rrugës duke bllokuar rrugën e automjetit të markës “BMW ... D” ngjyrë të kaltër me targa 04-...-FB të cilën e voziste N. D. i cili në momentin kritik ishte duke lëvizur në shiritin etij qarkulles, nga ana e kundërt , dhe për t’iu shmangur aksidentitkalon nga shiriti i majtë në të djathtë ku vie deri te goditja e pjesës së përparme të automjetit” VW V. “ ngjyrë hiri metalike me targa 04-...-AM të cilën e drejtonte B. K. i cili në momentin kritik ishte duke lëvizur në shiritin e tij qarkullues , nga drejtimi i kundërt me c’rast përvec dëmeve materile në të tri automjetet, lëndime të lehta trupore pësojnë : B. K. dhe M. K. lëndime këto më gjërësishtë të të konstatuara më mendimin e ekspertit mjeko ligjor të dr. M. G. të dhënë më dt 27.03.2017

Gjendjen e till faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajsisë nga ana e të pandehurit si dhe nga provat dhe faktet qe i përmban aktakuza kallzimi penal me nr. të rastit 2017-GR-0..., të datës 15.02.2017 i drejtorisë rajonale të policisë në Prizren, raporti fillestar i incidentit numri i rastit: 2017/GR/0... dt 15.02.2017, deklarata e të akuzuarit S. Z. të

dt.15.02.2017, deklarata e vozitësit të dëmtuarit B. K. te dt.16.02.2017, raportet mjekësore të QKMF Suharekë me numër.2..., 3...,3... dhe 3... të dt.15.02.2017, eksperiza mjeksore e ekspertit mjeko ligjor të dr. M. G. të dt.27.03.2017,ekspertizën e ekspertit te komunikacionit A. K. të dt.12.05.2017.

Nga këto fakte dhe prova të vertetuara në procedurë nga veprimet e të akuzuarit S. Z. përmbushën të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag.6 lidhur me parag.1 të KPRK-së, të cilën e ka kryer nga pakujdesia e vetëdijshme, pasi që ishte i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit të tij por me mendjelehtësi ka menduar se ajo nuk do të shkaktohet, apo se ky do të mund të parandaloj shkaktimin e saj.

I akuzuari e ka kryer veprën penale sepse në bazë të nenit 7 të KPRK-së, kjo vepër penale është e kundërligjshme e cila është e percaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e se cilës janë të percaktuar me ligj dhe për të cilën është percaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Për këtë vepër penale i akuzuari është shpallur fajtor sepse ne përputhje me nenin 17 parag.1 të KPK-së, kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nese është menderisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia.

Ne rastin konkret i pandehuri ketë veper e ka kryer me pakujdesi te vetëdijshme sipas nenit 23 parag.2 të KPK-së, ku dhe është shqiptuar sanksioni penal.

Gjatë percaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 73,74 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin muar faktin se e ka pranuar fajsinë, gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen do të këtë kujdes dhe nuk do të përsërisë vepra të tilla, është pënduar për këtë vepër penale, ndaj tij nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë tjetër penale, ka qenë bashkëpunues me gjykatën, ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Për këtë vepër penale është parapar dënimi me gjobë ose me burg deri në një vit, të njejtit iu shqiptua dënimi me gjobë në shumën prej 170 € (një qind e shatëdjetë Euro), me bindje se dënimi me gjobë është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmeris shoqërore të veprës penale dhe i përgjegjesisë penale të të akuzuarit dhe se i njejt dënim do të ndikoj që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandaloj përonat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqeror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimin që të dëmtuarit lidhur me kërkesën pasurore juridike për kompenzimin e dëmit të shkakuar me këtë vepër penale të udhëzoj në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 463 parag.2 të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kësaj kërkesë.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 451 parag.1, nenin 453 parag.1 lidhur me nenin 450 parag.2 nen parag.2.1 të KPP-së, ashtu që e detyrojë të akuzuarin që të paguaj shumën gjithsej prej 90.88 Euro (në emër të shpenzimeve te ekspertit te komunikacionit shumen prej 40.88 Euro, dhe në emër të shpenzimeve të ekspertit të mjeksisë ligjore shumën prej 50 Euro).

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi ne nenin 450 parag.3 të KPPK-së ashtu që lartësia e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 Euro u caktua duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale si dhe gjëndjen finanaciare të akuzuarit, ndërsa shumën prej 30 euro në emër të viktimave të krimit bazuar ne nenin 39 parag.3 të ligjit mbi kompenzimin e viktimave të krimit nr. 05/L-036.

Nga të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:044648, 21.02.2019

G j y q t a r i

Lavdim Bajraktari

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.